

## **AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

**Fjala e znj. Enkeleda Shehi, Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së**

*I nderuar z. Klosi,*

*E nderuar znj. Sayed,*

*Të nderuar kolegë dhe pjesëmarrës,*

*Mirëseerdhët!*

Ju falënderoj për praninë tuaj sot në këtë aktivitet të rëndësishëm të organizuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bashkëpunim me Bankën Botërore (BB) dhe Institutin e Statistikave të Shqipërisë (INSTAT).

Kam kënaqësinë dhe privilegjin të hap punimet e Konferencës njëditore “*Sistemi i pensioneve vullnetare në Shqipëri – zgjerimi i mbulimit*”. Në panelin e parë të konferencës do të kemi nderin të njihemi me mesazhet që do të përcillen prej përshëndetjeve të z. Klosi, Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë; znj. Sayed, Drejtore për Shqipërinë, Zyrës Përfaqësuese e Bankës Botërore në Shqipëri, z. Pescaru nga Autoriteti Mbikëqyrës i Rumanisë dhe znj. Beqiraj zëvendësministre e Ministrisë së Financave, njëherësh e angazhuar në vite me tregun e pensioneve si eksperte. I përmenda pjesëmarrësit në panelin e parë jo për të bërë paradë të personaliteteve, të cilët i falënderojmë që gjetën kohën të angazhohen me këtë konferencë por për të theksuar se në secilin prej përshëndetjeve të tyre do të gjeni mesazhe të rëndësishme në lidhje me zhvillimin e sistemit të pensioneve në vend. Këto mesazhe së bashku do të na mundësojnë një pamje të plotë të problematikave dhe objektivave që lidhen me sistemin e pensioneve, përfshi pensionet shtetërore dhe private, raporti i tyre me ekonominë e vendit në tërësi dhe nevojat për reforma, mbështetja që zhvillimi i këtij sistemi merr edhe nga politika fiskale e vendit, si dhe konteksti botëror në të cilin Shqipëria bën pjesë dhe do të duhet t’i përshtatet.

Në panelin e dytë të konferencës pjesëmarrësit do të kenë rastin të njihen me metodologjinë dhe rezultatet tepër interesante të vërtetimit të gjerë me ndërmarrjet që veprojnë në Shqipëri me mbi 20 të punësuar. Projekti i vërtetimit, i cili u krye në terren gjatë muajit qershor 2015, si një bashkëpunim i frutshëm i AMF-së me INSTAT dhe BB, njëllojësi na ka dhënë disa orientime të rëndësishme për organizimin e fushatave edukuese dhe promovuese për të nxitur interesin për produktet e tregut të pensioneve private dhe për zhvillimin në tërësi të këtij tregu. Rezultatet e këtij vërtetimi, të cilat do të na prezantohen nga eksperti i projektit z. Van Driel, i shërbejnë në mënyrë të drejtpërdrejtë AMF-së dhe shoqërive administruuese të fondeve të pensioneve për të organizuar strategjitë e tyre të veprimit por janë të përshtatshme edhe për të tjera autoritete politikëbërëse në fushën e tregut të pensioneve. Këto rezultate janë edhe të vlefshme nga ana statistikore, sepse ato janë nxjerrë, bazuar në një metodologji rigorozë grumbullimi dhe përpunimi, me të cilat do të na njohë drejtuesja e këtij projekti për INSTAT, znj. Dhuli. Në vijim, konferenca do të ballafaqojë qëndrimet dhe problematikat e grupeve të interesit dhe operatorët e tregut të pensioneve private dhe për këtë qëllim janë ftuar zonjat Josifi dhe Rada, përfaqësuese të punëdhënësve për të prezantuar filozofinë që ata kanë adoptuar kundrejt produkteve të tregut të pensioneve private, z. Hado aktualisht zëvendësdrejtor i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ish anëtar i Bordit të AMF-së dhe ekspert i fushës, i cili do të shprehë filozofinë e një institucioni buxhetor në raport me nxitjen e skemave profesionale, si dhe znj. Koçi dhe zotërinjtë Hasa e Hibraj drejtorë të përgjithshëm të shoqërive administruuese të fondeve të pensioneve vullnetare, të cilët do të njohin me strategjitë e tyre për zgjerimin e veprimtarisë dhe objektivat që kanë në të ardhmen jo vetëm në funksion të akomodimit të kërkesave por edhe për të nxitur kërkesën për produkte të tregut të pensioneve private.

Moderimi i zotërinjve Price nga Banka Botërore, Filipi, Drejtor i Përgjithshëm i INSTAT, dhe Pedrazzi, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Bankës Intesa San Paolo, përbën një kontribut jo vetëm për administrimin e panelin, por si ekspertë ata do të transmetojnë gjithashtu mesazhe të dobishme.

Kjo Konferencë trajton një mesazh të rëndësishëm, që zhvillimi i sistemit të pensioneve kërkon përpjekje dhe angazhim të të gjithë palëve të përfshira në proces; autoritetet shtetërore, operatorë

privatë të tregut; punëdhënës dhe punëmarrës për ta reformuar këtë sistem; dhe pa këtë bashkërendim nuk mund të sigurohet përmirësimi i nivelit të të ardhurave të popullsisë në moshë pensioni. Kjo sigurohet nëpërmjet nxitjes së zhvillimit jo vetëm të skemës së detyrueshme, apo shtetërore siç jemi mësuar ta quajmë, por edhe të skemave të tjera alternative private me natyrë vullnetare apo të detyrueshme.

Vitin e kaluar qeveria shqiptare ndërmoi një hap të rëndësishëm në reformimin e skemës së sigurimeve të detyrueshme shoqërore, që në publik njihet si reforma e pensioneve. Z. Klosi do të prezantojë një panoramë të gjerë të këtij aspekti prandaj më lejoni që të përqendrohem në aspektet e zhvillimit të tregut të pensioneve që mbikëqyret nga AMF.

Konferenca që po zhvillojmë sot është një veprimtari e rëndësishme që zhvillohet në kuadër të projektit që po zbaton AMF me mbështetjen e BB-së, me financim nga *FIRST Initiative* i projektuar në funksion të nxitjes së zhvillimit të tregut të fondeve të pensioneve vullnetare private dhe përmirësimit të mbikëqyrjes së këtij tregu.

Projekti “*Mbikëqyrja e pensioneve dhe zgjerimi i mbulimit*” ka filluar në korrik të vitit 2014 dhe pritet të përfundojë në tremujorin e parë të vitit 2016. Ai ka dy komponentë kryesorë, të cilët janë: mbikëqyrja e tregut të pensioneve dhe zgjerimi i këtij tregu. Komponenti i parë është i fokusuar në përmirësimin e aftësisë mbikëqyrëse të AMF-së për operatorët e këtij tregu, përkatësisht shoqëritë administruese të fondeve të pensioneve dhe depozitarët e tyre, si dhe hartimin e metodologjisë së mbikëqyrjes me bazë rrezikun. Në këtë komponent puna po përqendrohet në vlerësimin diagnostikues të kapacitetit mbikëqyrës dhe ndërtimit të planit të veprimit për forcimin e kapacitetit; në hartimin e manualit të ciklit të plotë mbikëqyrës me bazë rreziku; në rishikimin e kuadrit rregullativ dhe ligjor të fushës; si dhe trajnimin e punonjësve të mbikëqyrjes.

Deri më tani është punuar intensivisht me dy elementë: hartimin e manualit të mbikëqyrjes me bazë rrezikun dhe amendimet e ligjit për fondet e pensionit vullnetar. Në lidhje me manualin janë diskutuar dhe përpiluar objektivat e mbikëqyrjes, strategjitë e rrezikut dhe proceset e vlerësimit

të rrezikut, ndërtimin e hartës së rreziqeve, si dhe proceset e inspektimit në vend dhe analizës së raporteve.

Në janar të 2014-ës me ndihmën e ekspertëve të Bankës Botërore filloi puna për ndryshimet në Ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, e cila vijoi edhe në kuadër të projektit të financuar FIRST. Amendimet e propozuara synojnë përmirësimin dhe rregullimin e mëtejshëm të ligjit për ta përshtatur me zhvillimet e fundit në fushën e pensioneve vullnetare, me direktivat e BE-së, si dhe në zbatimin të MSA-së dhe rekomandimeve të progres raporteve të BE-së. Përmirësimi i kuadrit ligjor lindi edhe si nevojë për përmbushjen e angazhimeve të marra në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2015 - 2020 (miratuar me VKM nr. 404, datë 13.05.2015). Progres Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë në kapitullin e shërbimeve financiare ka rekomanduar nevojën për përpjekje shtesë për përafrimin e legjislacionit me *acquis* në fushën e pensioneve vullnetare.

Aktualisht, jemi në fazën e përmbylljes së komenteve nga institucionet e tjera dhe operatorët e tregut të pensioneve dhe ligji pritet të kalohet në qeveri për miratim. Të interesuarit kanë mundësi të njihen me amendimet e propozuara, pasi ato janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të AMF-së.

Është e rëndësishme të kuptohet që zgjerimi i tregjeve financiare në tërësi e ndikon pozitivisht në ekonominë e një vendi. Zgjerimi i tregut të pensioneve krijon në një ekonomi ofertën e nevojshme për punëdhënësit dhe punëmarrësit, me produkte të kursimeve afatgjata. Edhe më e rëndësishme konsiderohet oferta e këtij tregu në kushtet kur në Shqipëri, ashtu si edhe në vende të tjera, po vërehen ndryshime demografike, të cilat bëjnë të domosdoshëm rritjen e shkallës së kursimit të popullatës për moshën e shtyrë. Duke u bazuar në këto çështje, konsideruar si të domosdoshëm që komponenti i dytë i projektit të fokusohet në nxitjen e zgjerimit të tregut të fondeve të pensioneve vullnetare private. Pa e nxitur zgjerimin e këtij tregu, edhe praktika dhe kapacitetet mbikëqyrëse të AMF-së do të mbeten të kufizuara.

Baza ligjore për zhvillimin e tregut të pensioneve në Shqipëri është relativisht e hershme me miratimin në vitin 1995 të ligjit, që rregullonte veprimtarinë e intituteve të pensionit dhe të

autoritetit rregullator e mbikëqyrës përkatës. Pavarësisht kësaj, prej miratimit të ligjit të pensioneve për herë të parë e deri më sot tregu i pensioneve ka patur zgjerim të kufizuar dhe ka një peshë pothuaj të papërfillshme në tregjet që mbikëqyr AMF. Që nga licencimet e para e deri më sot tregu i pensioneve përbëhet nga tre shoqëri administruese të fondeve të pensionit, ku secila ka nën administrim një fond pensioni, si dhe dy depozitarë. Në total, në qershor 2015, tregu i pensioneve ka asete neto nën administrim prej rreth 754.8 milionë lekë (afërsisht 5.4 milionë euro), 93 plane pensioni dhe rreth 10,791 anëtarë.

Nga një krahasim i shpejtë në kohë i të dhënave, vërehet që ky treg rritet me ritme të larta. Numri i anëtarëve vetëm në gjashtëmuorin e parë të vitit 2015 u rrit me 27.1%, ndërsa po ta krahasojmë me qershorin e një viti më parë rritja është rreth 29%. Po të konsiderueshme janë ritmet e rritjes së totalit të aseteve neto nën administrim. Për gjashtëmuorin e parë të vitit 2015 ato janë rritur me 19.98%, ndërsa krahasuar me një vit më parë (pra, me qershor 2014) rritja është 41.39%.

Pavarësisht ritmeve të larta të zgjerimit, përsëri tregu është i kufizuar. Në fund të vitit 2014 ky treg përbënte 0.7 përqind të totalit të tregjeve financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së dhe është pothuaj i papërfillshëm në raport me Produktin e Brendshëm Bruto (PBB) në vetëm 0.05%. Ky kufizim i tregut të pensioneve në vite, bëri të domosdoshëm që AMF të përqendrojë vëmendjen drejt nevojës së zgjerimit të tij.

Në këtë ecuri të tregut të pensioneve private mund të kenë ndikuar një mori faktorësh, të cilët duket se nuk e kanë mbështetur zgjerimin e tij. Një faktor vlerësohet se është besimi ende i pakonsoliduar në sistemin që ofron produkte kursimesh, si rrjedhojë e krizave të ashpra financiare të përjetuara nga vendi në vitet 1990 dhe 1997, veçanërisht kjo e fundit e shkaktuar nga shembja e skemave piramidale. Një tjetër faktor i rëndësishëm vlerësohet mungesa e traditës së popullatës në investime afatgjata private në produkte të tregut të pensioneve. Përveç këtyre faktorëve, vlerësohet se deri në vitin 2014 ka ndikuar mos ofrimi i nxitësve fiskalë për kontributet në skemat private vullnetare si për punëmarrësit edhe për punëdhënësit. Për rrjedhojë, investimi në produktet e pensioneve konsiderohej në disavantazh në raport me investimin në

produkte të tjera financiare. Mungesa e zhvillimit të tregut të kapitalit është një faktor tjetër, i cili ka ndikuar që edhe vetë operatorët e tregut të pensioneve të kenë strategji më të kufizuara zgjerimi, në mungesë të alternativave për investimin e fondeve që grumbullojnë. Po ashtu prania e ekonomisë joformale, e cila ka krijuar problem edhe për vetë skemën e detyrueshme e për rrjedhojë ka penguar zgjerimin e skemës private.

Prandaj, duhet kuptuar se nxitja e zgjerimit të tregut nuk është një çështje afatshkurtër, por do të kërkojë një kuadër hapash për t'u ndërmarrë në periudhë afatmesme dhe me rezultate që mund të bëhen të dukshme në periudha afatmesme dhe afatgjatë. Por ajo çka ka rëndësi është që të fillohet nga ky moment për të ardhmen. Përcaktimi i mënyrave të veprimit përbën një strategji të veçantë të zgjerimit të tregut të pensioneve private. Hapi i parë në këtë veprim strategjik është studimi i terrenit mbi të cilin do të punohet për të nxitur zgjerimin e tregut të pensioneve. Pikërisht këtij qëllimi i shërben ndërmarrja, bashkë me INSTAT, e një vrojtimi me mbi 500 ndërmarrje në të gjithë territorin e vendit, që kanë 20 e më tepër të punësuar dhe që ushtrojnë aktivitetin e tyre në të gjitha degët e ekonomisë të përcaktuara sipas nomenklaturës zyrtare. Siç e theksova në fillim në këtë konferencë do të keni rastin të njiheni me rezultatet e këtij vrojtimi dhe anën metodologjike të tij. Por unë do të doja të vija theksin në disa aspekte mjaft të rëndësishme nga pikëpamja e politikëbërësve dhe në veçanti e autoritetit rregullator.

Nga vrojtimi rezultoi se, në tërësi, njohuritë që kanë punëmarrësit dhe punëdhënësit për planet e pensionit profesionale dhe individuale janë mjaft të kufizuara. Një shkallë e konsiderueshme prej rreth 1/3 së punëdhënësve dhe rreth 1/2 e punëmarrësve nuk kishin njohuri. Edhe ata që janë shprehur se kanë njohuri për planet e pensionit, janë të përqendruar në nivelin e njohurive më pak sesa niveli mesatar. Duke patur parasysh që niveli i njohurive është përcaktuar me vetëvlerësim, kuptohet që në realitet shkalla e njohurive mund të jetë edhe më e ulët. Mbi bazën e këtij rezultati për AMF-në por edhe për shoqëritë administruese të fondeve të pensioneve, del një detyrë mjaft e qartë që të organizojnë fushata edukuese me punëmarrës dhe punëdhënës. Synimi duhet të jetë njohja me produktet e tregut të pensionit, dobishmëria e konsumimit të këtyre produkteve dhe përfshirja në plane pensioni. Sigurisht që kjo do të përbëjë një detyrë të

rëndësishme për periudhën afatmesme për AMF-në dhe duhet të jetë pjesë e veprimtarisë së përditshme të shoqërive administruese.

Në lidhje me përcaktimin e mënyrës më të përshtatshme për dhënien e informacionit, nga vërtetimi rezulton, që përgjithësisht ndërmarrjet kanë pritshmëri që AMF dhe shoqëritë administruese të japin më shumë informacion. Madje preferohet dhënia e informacioneve në formë të shkruar. Kjo preferencë shprehet nga 77.3% e ndërmarrjeve të vërtetuara. Ndërsa si formë e dytë e preferuar gjerësisht (mbi 60% e ndërmarrjeve të vërtetuara) është kryerja e prezantimeve për drejtuesit dhe punonjësit e ndërmarrjeve. Përsëri ky rezultat përcakton për AMF-në dhe shoqëritë administruese një mesazh të qartë mbi mënyrat që duhet të përdorin në fushatat edukuese dhe të marketingut.

Siç pritej, një numër shumë i vogël punëdhënësish ofrojnë plane pensioni profesionale për punëmarrësit e tyre. Nga popullata e ndërmarrjeve të vërtetuara vetëm 22 ndërmarrje ose 1.06% ofrojnë plane pensioni, kundrejt 98.94% që nuk ofrojnë plane të tilla. Ky rezultat është në përputhje me kufizimin në vite të tregut të pensioneve private në raport me tregun financiar. Vlen të theksohet fakti që në grupin e ndërmarrjeve që ofrojnë plane pensioni, kryesisht ato janë ndërmarrje me kapital të huaj dhe që ushtrojnë aktivitetet administrative e mbështetëse dhe financiare e të sigurimeve dhe janë të përqendruara në qarkun e Tiranës (megjithëse është e rëndësishme të shënohet që ndërmarrjet me kapital shtetëtor nuk u përfshinë në vërtetimin përbëjnë një burim kërkesë për pensione private). Ky rezultat e vërteton, që zgjerimi i tregut të pensioneve private ndikohet edhe nga kultura apo tradita e të bërit biznes nga ana e punëdhënësve. Tradita e vonë e të bërit biznes privat në Shqipëri sigurisht që nuk është shoqëruar edhe me konsolidimin e traditës së ofrimit të planeve të pensionit për punëmarrësit. Kjo lidhet edhe me strukturën e tregut të punës ku krahu i punës ka qenë gjithnjë me ofertë më të lartë sesa kërkesa për të. Edhe për këtë element është e qartë që fushata edukuese ndihmon në rritjen e njohurive e bashkë me to edhe të formimit e konsolidimit të një kulture më sociale në trajtimin e punëmarrësve.

Një element të fundit që do të doja të theksoja nga vërtetimi është faktori i besimit në sistemin financiar, në tërësi, dhe në operatorët e tregut të pensioneve, përfshi edhe AMF-në, në veçanti.

Nga grupi i ndërmarrjeve të vrojtuar që nuk ofrojnë plane pensioni por kanë interes t'i ofrojnë, rezulton se faktori i besimit ndikon në masë të rëndësishme në mospërbushjen e këtij interesi. Nga këto ndërmarrje, rreth 31% shprehen se mospasja e besimit të mjaftueshëm në shoqëritë administruese të fondeve të pensionit dhe rreth 23% shprehen se mospasja e besimit të mjaftueshëm në tërësi për sistemin financiar janë faktorë, të cilët ndikojnë që të mos realizohet plani i ndërmarrjeve për të ofruar plane pensioni.

Gjithashtu, në përgjithësi ndërmarrjet e vrojtuar perceptojnë besim nën nivelin mesatar për këto institucione. Nuk po zgjatet në dallimet e rezultateve për shkallën e besimit për operatorët e tregut të pensioneve dhe autoritetin rregullator por dua të theksoj se në nivelin e besimit duket se ndikon një kombinim i gjerë faktorësh, ku më të rëndësishmit janë strategjia e marketingut e ndjekur nga shoqëritë administruese të fondeve të pensionit, si dhe shkalla e njohjes së këtyre institucioneve.

Ajo që ka rëndësi është fakti që faktorët e besimit kanë një ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen apo qëndrimin e punëdhënësve në lidhje me ofertën e planeve të pensionit. Pra, për shoqëritë administruese të fondeve të pensioneve është e nevojshme të kryejnë një aktivitet më intensiv për të bashkëpunuar me punëdhënësit dhe punëmarrësit, me qëllim rritjen e shkallës së njohjes së tyre si subjekte; të produkteve që ato ofrojnë, si dhe të organizojnë fushata marketingu transparente për këto produkte. Kjo sjellje pritet të ndikojë në zgjerimin e tregut të pensioneve. Nga ana tjetër, edhe vetë AMF ka një rol të rëndësishëm si në procesin e edukimit konsumator ashtu edhe në forcimin e besimit në tregjet financiare që mbikëqyr. Këtyre objektivave do t'i shërbehet nëpërmjet rritjes së pranisë në publik nga ana e AMF-së dhe rritjes së theksit në planet afatmesme të institucionit të elementët e edukimit dhe mbrojtjes konsumatore.

Në përfundim të analizës së rezultateve të vrojtimit të kryer me ndërmarrjet mund të themi se:

- Faktorët fiskalë, në veçanti, deri në vitin 2014 kanë frenuar zhvillimin e tregut të pensioneve;



- Klima e biznesit dhe faktorët kostos janë elementë shtesë që kanë kufizuar ndjeshëm kërkesën për produkte të tregut të pensioneve private;
- Shkalla e njohurive për produktet e tregut të pensioneve private është mjaft e kufizuar, si nga punëdhënësit edhe nga punëmarrësit;
- Shkalla e besimit në sistemin e financiar rezulton e brishtë.

Zhvillimi i tregut të pensioneve private është e qartë se kërkon që të ndërtohet një ambient i qëndrueshëm makroekonomik për të nxitur kërkesën dhe ofertën për produktet e tregut të pensioneve private. Kombinimi aktual i rrethanave e bën më të efektshëm që veprimi të përqendrohet në nxitjen e ofertës. Zgjerimi i aktivitetit të fondeve të pensioneve në periudhë afatgjatë pritet të kontribuojë në rritjen e kërkesës për gamën e produkteve financiare që ofrohen nga tregu i kapitalit dhe do të ndihmojë në përmirësimin e qëndrueshmërisë fiskale duke ofruar burime për financimin e rritjes së pensioneve në tërë ardhmen ndërkohë që popullsia plakët.

Nga ana tjetër, fondet e pensioneve mund të jenë një faktor i rëndësishëm për të imponuar disiplinë në qeverisjen e shoqërive aksionare në një vend. Një element i tillë duhet konsideruar i rëndësishëm edhe për zhvillimin e një tregu tjetër, atë të kapitalit, sepse krijimi i një mjedisi të përshtatshëm investimi është jetësor për të ulur varësinë prej letrave me vlerë të qeverisë, për të rritur burimet e financimit për kompanitë në Shqipëri dhe për të rritur diversifikimin në investim për kursimtarët në Shqipëri. Si i tillë, AMF e konsideron **reformën për zgjerimin në skemat e detyrueshme me administrim privat si të një rëndësie shumë të madhe dhe shpreh gatishmërinë për të drejtuar këtë reformë në vitet që vinë**, me mbështetjen e të gjithë aktorëve institucionalë dhe partnerëve ndërkombëtarë, duke ndjekur hapat e një pas njëpasnjëshëm të rekomanduar nga FSAP. Duke marrë parasysh kompleksitetin dhe rëndësinë e një reforme të tillë, AMF po punon për të **forcuar kapacitetet mbikëqyrëse të tregjeve financiare**.

Të nderuar pjesëmarrës,

Kam bindjen se Konferenca do të përçojë mesazhe që janë të rëndësishme për nxitjen e zhvillimit të tregut të pensioneve private në vend. Prania Juaj, z. Ministër, në këtë Konferencë na

e përforcon bindjen se reformimi i sistemit të pensioneve konsiderohet si një vullnet i përbashkët ku skema e detyrueshme dhe ato alternative duhet të konsiderohen si plotësuese të njëra-tjetrës, në shërbim të mbështetjes së nivelit të jetesës së popullsisë.

Ju falënderoj për vëmendjen,